



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:139894

Datë: 28.02.2023

Numri i dokumentit: 04027124

APS.nr.2/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti Special, në Kolegjin Penal të përbërë nga gjyqtarët, Bashkim Hyseni kryetar i kolegjit, Burim Ademi dhe Aferdita Bytyçi anëtare, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Alba Makolli, në çështjen penale kundër të akuzuarit I.T. për shkak të veprës penale Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar apo etnik nga neni 147 paragrafi 1 i KPRK-ës, duke vendosur në lidhje me ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, dhe ankesën e mbrojtësit të akuzuarit I.T. avokati Nebojsa Vllajiq, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Special, PS.nr.59/2021 të dt.19.10.2022, në seancën e kolegjit me datë 20.02.2023 mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN si të pabazuara ankesat e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe e mbrojtësit të të akuzuarit I.T. av. Nebojsa Vllajiq, ashtu që aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë PS.nr. 59/2021 i datës. 19.10.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti Special ka marrë aktgjykimin PS.nr.59/2021 të datës.19.10.2022, me të cilin aktgjykim e ka shpallur fajtor të akuzuarin I.T. për veprën penale

Nxitja e urrejtjes, përparjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar apo etnik nga neni 147 paragrafi 1 i KPRK-ës, për të cilën vepër penale e ka dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 viti, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Po ashtu ka obliguar të akuzuarin që të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, dhe për paushallin gjyqësor në lartësi prej 100 euro si dhe shumën prej 50 euro në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit, në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi kanë parashtruar ankesë:

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimin mbi sanksionin penal, me propozimin që gjykata e Apelit të aprovoj ankesën dhe aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj ashtu që të pandehurit ti shqiptohet një dënim më i ashpër.

Mbrojtësi i të pandehurit I.T. av. Nebojsa Vllajiq, për shkak të: vërtetimit të gabuar dhe jo të plote të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal, shkeljes së dispozitave të procedurës penale, shkeljes së të drejtës të garantuar me Konventën Evropiane nga neni 10 e drejta e lirisë së shprehjes, dhe vendimit mbi sanksionin penal, duke propozuar që gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën e mbrojtjes ta anuloj aktgjykimin e ankimuar, dhe të pandehurin ta liroj nga akuza, pasi që vepra penale për të cilën ngarkohet nuk përbën vepër penale.

Mbrojtja ka parashtruar edhe përgjigje në ankesën e prokurorisë, me anë të së cilës ka parashtruar kundërshtimet në ankesën e prokurorisë dhe ka propozuar që ankesa e Prokurorisë të refuzohet, ndërsa të aprovohet ankesa e mbrojtjes.

Prokuroria e Apelit, ka paraqitur parashtrësën me shkrim PPA/I.nr.24/23 të datës 30.01.2023, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Speciale e Republikës së Kosovës, ashtu që të ndryshohet aktgjykimi lidhur me cilësimin juridik dhe të shqiptohet një dënim më i ashpër ndaj të pandehurit me burgim.

Gjykata e Apelit ka caktuar seancën e kolegjit, në mbështetje të nenit 390 për të cilën seancë ka ftuar palët, ashtu që në seancën e kolegjit nuk ka prezantuar prokurori i Prokurorisë së Apelit edhe pse është njoftuar në mënyrë të rregullt për seancën e kolegjit, nuk ka prezantuar as i

pandehuri I.T. përkundër se është ftuar në mënyrë të rregullt, ndërsa ka prezantuar mbrojtësi i të pandehurit av. Nebjsa Vllajiq.

Gjykata e Apelit pasi që ka studiuar aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të Prokurorisë Speciale dhe mbrojtësit të akuzuarit, propozimin e Prokurorisë së Apelit, dhe duke analizuar shkresat e lëndës në këtë çështje penale në vështrim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale, gjeti se:

Ankesat janë të pabazuara.

Pretendimet ankimore.

Prokuroria në ankesën e parashtruar thekson se, në aktgjykimin e ankimuar lidhur me rrethanat që gjykata ka marrë për bazë për të vlerësuar llojin dhe lartësinë e dënimit, rezulton se janë marrë për bazë sjellja e të pandehurit në gjykim, që prokuroria këtë rrethanë e konteston si faktor që ndikon në dënim pasi që është detyrim i çdo pale që ti përmbahet rregullave në kuadër të procesit gjyqësor, dhe si e tillë kjo rrethanë nuk ka peshë, po ashtu lidhur me rrethanën lehtësuese se i pandehuri nuk është i dënuar më parë, prokuroria thekson se një rrethanë e tillë nuk duhet të ketë këtë peshe marrë për bazë rrezikshmërinë shoqërore që përbën vepra penale për të cilën është shpallur fajtor i akuzuari kur dihet se kjo veprë penale është e kategorizuar në kuadër të veprave penale kundër rendit juridik dhe kushtetues të vendit, andaj pesha e rrezikshmërisë së vet veprës penale krahas rrethanës që gjykata ka marrë për bazë ndaj të pandehurit për të kaluarën kriminale, kjo si e tillë nuk ka ndonjë peshe specifike në raport me këtë veprë penale.

Prokuroria thekson po ashtu se rrethanat rënduese nuk janë vlerësuar drejt nga gjykata, konkretisht motivi i kryerjes së veprës penale që ka të bëjë me mohimin e masakrës së Reçakut dhe masakrave të tjera në Kosovë, po ashtu theksohet se është dashur të vlerësohet drejt shkalla e përgjegjësisë penale ndërlidhur me motivin për kryerjen e veprës penale nga gjykata e shkallës së parë, dhe se si shkak e kësaj ka mundur lehtësisht që të vijë deri te eskalimi i një situatë në vend.

Prokuroria pretendon se gjykata e shkallës së parë nuk ka zbatuar drejt ligjin penal edhe pse ka konstatuar se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elementet e veprës penale nga neni 147 paragrafi 1 i KPRK-ës, për këto arsye prokuroria vlerëson se gjykata gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike kur ka ri kualifikuar veprën penale me rastin e marrjes së aktgjykimit nga neni

147 paragrafi 2 në nenin 147 paragrafi 1, që rrjedhimisht kjo ka shkaktuar edhe përcaktimin e sanksionit penal e që për prokurorinë përveç se është sanksion i ulët njëkohësisht nuk i përgjigjet peshës dhe pasojave të shkaktuara të veprës penale.

Po ashtu prokuroria i referohet arsyeve të dhëna në aktgjykimin e ankimuar, kur vet gjykata në aktgjykimin e ankimuar ka konstatuar se, “ bazuar në shkresat e lendes – provat e administruara del se është fakt i pakontestueshëm se i pandehuri derisa ishte Ministër i Administratës dhe pushtetit lokal me date 24/03/1999, me dashje ka nxitur dhe përhapur publikisht urrejtje dhe i referohet pjesës së dispozitivit të aktgjykimit. Po ashtu theksohet se nuk ka qenë kontestues fakti se i pandehuri kishte vepruar sipas asaj që theksohet në dispozitiv që rezulton edhe nga CD-ja, po ashtu se nga provat vet gjykata ka konstatuar se janë përmbushur elementet e veprës penale nga neni 147 paragrafi 1 i KPRK-ës. Përtej këtyre arsyeve prokuroria thekson se veprimet e të pandehurit kanë nxitur protesta dhe pakënaqësi tek shoqëria civile dhe komunitetet e tjera në Kosovë pasi që ka të bëjë me mohim të masakrës së Reçakut dhe masakrave të tjera.

Prokuroria thekson se pavarësisht faktit se ditën e veprimit të të akuzuarit ka qene ditë e diele, dhe nuk ka qenë ditë pune, i pandehuri ka vepruar nën petkun e ministrit të qeverisë së Republikës së Kosovës, ka shkuar në tubim me qytetarët serbe dhe atë me dashje dhe me vetëdije të plotë i është drejtuar masës duke nxitur dhe përhapur publikisht urrejtje dhe përçarje midis grupeve kombëtare dhe etnike që jetojnë në Republikën e Kosovës e që shkaktojnë pasoja të rënda, në kuadër të këtyre rrethanave provat e ofruara nga prokuroria kane qenë të mjaftueshme dhe bindëse qe gjykata të jap një aktgjykim me të rëndë dënues, kjo për faktin se i pandehuri ka vepruar me dashje direkte dhe si person zyrtar.

Mbrojtja e të pandehurit në ankesë lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave te procedurës penale, përveç se thekson se kjo çështje penale është dashur të gjykohet në Gjykatën Themelore në Mitrovice dhe ankesa të trajtohet në Divizionin e Gjykatës së Apelit në Mitrovice pasi që veprimi i të pandehurit pretendohet se ka ndodhur në Mitrovicë, njëkohësisht theksohet se si pasojë e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike ka ardhur edhe deri te shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 paragrafi 1 nën paragrafi 12 lidhur me nenin 370 paragrafi 7 sipas së cilës dispozite gjykata duhet në mënyrë të qartë të arsyetoj se cilat fakte dhe për çfarë arsye i konsideron të vërtetuara. Mbrojtja thekson se neni 22 i Kushtetutës ka përcaktuar se Konventa Evropiane për të drejtat dhe liritë e njeriut është e aplikueshme drejtpërdrejt në Kosovë, e cila është zbatuar në disa raste në Kosovë, “ dhe

Komuna e Prizrenit, po ashtu mbrojta thekson se neni 53 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se të drejtat e njeriut të garantuara me Kushtetutën e vendit duhet interpretuar në përputhje me praktikën e Gjykatës Evropiane për të drejtat dhe liritë e njeriut, dhe kjo normë kushtetuese është e qarte dhe obligon të gjitha institucionet në Kosovë, dhe se nuk ka mëdyshje që Konventa evropiane për të drejtat dhe liritë e njeriut është pjesë integrale e sistemit juridik të vendit. Po ashtu dispozita e nenit 10 nga KEDNJ, e drejta e lirisë së shprehjes, e cila dispozite është një ndër të drejtat më të rëndësishme dhe më themelore për një shoqëri demokratike, dhe kjo e drejtë përfshinë ” *Informacionin apo Idenë*”, qofshin ndaj atyre që i pranojnë apo ndaj atyre që nuk i pranojnë apo që mund të shokohen, por kjo e drejtë nuk e ruan vetëm të drejtën tone për liri të shprehjes por edhe të drejtën tonë për mendimin e lire. E drejta e lirisë së shprehjes si nocion është shumë e zgjeruar por mund të kufizohet vetëm në disa raste specifike, që rastet me të njohura janë mohimi i holokaustit por duhet theksuar se veprimi i të pandehurit T. është shumë larg këtij shembulli dhe nuk ka asnjë ngjashmëri të tillë. Mbrojta thekson se GJEDNJ ka pasur disa raste që ka trajtuar për sa i përket shkeljes së nenit 10 nga shtetet e caktuara, e ku ka theksuar nenin 17 të konventës, “ ndalimin e shpërdorimit të të drejtave”, që gjykata ka theksuar se kur deklaratimet thirrin në dhunë nuk janë në përputhje me vet preambulën e Konventës. Deklarata e T. është deklaratë e të shkuarës, që nuk përmban asnjë thirrje në hakmarrje, as në dhunë ndaj kujtqo qoftë as konkretisht e as në mënyrë abstrakte, dhe se deklarimi i tij i referohet ngjarjeve para 20 viteve që nuk ka asnjë lidhje me veprimet e askujt pas 20 viteve dhe tani. Neni 10 siç ka përcaktuar praktika gjyqësore e GJEDNJ-ës, thekson se duhet të ketë një qëllim legjitim, dhe deklarata e T. nuk mund të justifikoj këtë qëllim, sepse shkaqet e këtij qëllimi janë të përcaktuara si, interesi i sigurisë nacionale, integritetit territorial dhe i sigurisë, parandalimin e trazirave dhe kriminalitetit, ruajtjen e shëndetit apo moralit, ruajtjen e reputacionit apo të drejtave të tjetrit, etj, dhe asnjë nga këto shkaqe në rastin konkret prek këto kushte, e edhe me interpretimin me të zgjeruar për ruajtjen e reputacionit apo të drejtave të tjera. Mbrojtja thekson se GJEDNJ kërkon që kushtëzimet e të drejtës së lirisë së shprehjes duhet të jenë me qëllim për ruajtjen e rendit dhe qetësisë dhe se institucionet duhet të mbrojnë qytetarët nga dhuna që do të kryhet, dhe se GJEDNJ ka përcaktuar një kriter shumë të lartë si, “domosdoshmëria e nevojës shoqërore”, e që domosdoshmëria nënkupton diçka të pa shtyrë diçka të pashmangshme, diçka të nevojshme për shoqërinë, siç thekson mbrojtja që ishte kriter në rastin, “Stomakhin kundër Rusise, 09.05.2018”, po ashtu mbrojta i referohet edhe rasteve të tjera të GJEDNJ-ës, për të bërë krahasim në rastin e të pandehurit T. në mënyrë që të vë në pah se kemi të bëjmë me të drejtën e lirisë së shprehjes dhe jo me veprën penale e që të gjitha këto i ndërlidhë me shkeljet esenciale lidhur me nenin 384 paragrafi 1 nën paragrafi 12 lidhur me nenin 370 paragrafi 7, që aktgjykimi

i ankimuar nuk i ka dhënë arsytet për faktet vendimtare për lidhur me atë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron si të vërtetuara.

Mbrojtja lidhur me shkeljen e ligjit penal, thekson se Prokuroria Speciale i ka ngarkuar me aktakuze të pandehurit veprën penale nga neni 147 paragrafi 2, ashtu që gjykata nuk ka aprovuar një kualifikim të tillë por se e ka shpallur fajtor të pandehurin për veprën penale nga neni 147 paragrafi 1 i KPRK-ës. Qysh në fillim të çështjes penale ne kemi theksuar se i pandehuri nuk ka prezantuar ditën kritike në cilësinë e ministrit, dhe vetëm në rigjykim një pretendim i tillë është pranuar. Ne po ashtu kemi theksuar se veprimet e te pandehurit nuk kanë të bëjë me vepër penale që jemi mbështetur ne nenin 250 të KPP-ës, që për shume arsye akuza është dashur të hedhet.

Nuk ka gjasa që veprimi inkriminues të cenoj rendin publik siç është përcaktuar në formën themelore te inkriminimit nga neni 147, jo vetëm që nuk ka pasur gjasa por kjo nuk ka ndodhur asnjëherë, përveç disa kategorive politike që kanë gjykuar një deklaram të tille ndryshe kjo deklaratë nuk ka krijuar cenim të rendit publik, e as që ka mundur të krijoj, përveç disa shkrimeve në media dhe përveç përfitimit të poenëve politik nga disa politikan të Kosovës, ndryshe nuk ka pasur fare rëndësi e tillë, asnjë qytetar i Kosovës nuk ka dal në rrugë si pasojë e kësaj deklarate nuk ka pasur protesta apo demonstrim, apo bllokadë rruge pra nuk ka ndodhur asgjë me rëndësi ndaj rendit publik. Theksimi i gjykatës se veprimet e të pandehurit kanë mundur ta prishin rendin juridik, është një gabim i thellë, dhe i paargumentuar, sepse gjykata me asnjë fjalë nuk ka theksuar se pse vlerëson se kanë mundur ta prishin rendin juridik kur nuk ka ardhur te asnjë shqetësim e as qe ka mundur të vijë, e ndërsa në rastet tjera edhe kur ka pasur shqetësime të tilla siç ishte ai i A.J. nuk ishte ndërmarr asnjë ndjekje penale për atë çfarë ai kishte thënë, ajo çfarë i akuzuari ka deklaruar nuk përbën vepër penale e madje as nuk mund të kryhet vepra penale në mënyrën e tillë pasi që është delikt verbal një veprim i tillë, dhe nëse Kosova pretendon se është një shoqëri demokratike një e drejtë e tillë e lirisë se shprehjes nuk mund të kufizohet qoftë edhe kur shumica e popullatës nuk përkrah mendimin e tillë. Në diskutim një ministër duhet të ketë dy nivele përgjegjësie që është ajo ligjore dhe politike, Përgjegjësi ligjore nuk ka dhe ajo është e dukshme në të gjitha ato vende ku theksohet se ka një shoqëri demokratike, dhe që respektohen të drejtat e njeriut, përgjegjësia politike është diçka tjetër, që padyshim ka ekzistuar dhe ai është shkarkuar me vendimin e Kryeministrit të Kosovës në procedure të shpejtuar dhe ai tashmë nuk është Ministër. Pavarësisht se shfrytëzojmë shoqërinë demokratike për të thënë atë që mendojmë nuk janë të gjitha deklaratat në interes, disa janë edhe deklarime politike në jetën tonë që krijojnë pasoja e që jemi te vetëdijshëm dhe i pranojmë, e qe nuk ka qenë as qëllim që Ministri të mbetet

në pozitën e tillë kur ka një qëndrim të tillë. Disa deklarime mund të jenë të lejueshme nga aspekti ligjor penal por mund të jenë në kundërshtim me qëndrimet e shumicës apo të pakicës së shoqërisë e të papranueshme nga aspekti moral, që mund të thuhet se edhe deklarimi që është në këtë çështje penale bie në këtë kategori. Mbrojtja thekson se unë mund të them se, “Gjermanet ne vitin 1941 gjatë okupimit nuk kanë vrare askënd ne Kragujevc, e jo me disa mijëra siç ka qene rasti....”, po ashtu mund te them se “Skënderbeu ka qene Serb, siç mund te them se Marko Kraljeviq ka qene Shqiptar”, mund te them se “ushtria Amerikane nuk ka hedhur bombën atomike ne Hiroshime dhe Nagasaki, dhe se ajo ishte tërësisht një propagandë Japoneze” të gjitha këto do të mund të konsideroheshin jo morale apo mund të më shpërfaqnin mua jo mirë por këto nuk kanë të bëjnë me veprim kriminal.

Mbrojtja thekson se kjo çështje penale nuk ka asnjë rëndësi tjetër përveç interesimit mediatik dhe politik, dhe e ka arritur atë interesim, por asgjë më shumë se kaq, është koha që për shoqërinë kosovare dhe procesin demokratik që është i domosdoshëm që besojmë se e dëshirojnë gjithë qytetarët kjo çështje të zgjidhet në frymën demokratike e kjo mund të arrihet vetëm nëse i pandehuri lirohet nga akuza, që përkundër se nuk ka ndodhur vlerësojmë se nuk është vonë të ndodhe edhe në Gjykatën e Apelit, e nëse ankesa jone nuk është e suksesshme atëherë, çështja do të përfundoj në Gjykatën Kushtetuese por edhe pranë institucioneve ndërkombëtare, sepse nga principet që kemi theksuar në ankesë ne nuk mund të heqim dorë.

Duhet theksuar se deklarimi i të pandehurit mund të interpretohet në mënyra të ndryshme por ai nuk mund të pranoj se ka pasur qellim që ta fyej ndokënd, kur kjo nuk është e vërtetë, por ai sërish ka kërkuar falje ndaj gjithë atyre që janë ndier të fyer apo lënduar.

Lidhur me dënimin mbrojtja thekson se, lidhur me sanksionin nuk mund të flitet fare përderisa nuk ekziston vepra penale, por përkundër këtyre thekson se një dënim i tillë është tërësisht jo proporcional, nga se askund nuk ka ndodhur që të shqiptohet një dënim me burgim, qoftë në shtete evropiane apo edhe në Amerikë, madje edhe ne rastin e Bosnjës ku është gjykuar S.. për natyrë të njëjtë të veprës penale në rrethana shumë më të renda ka qenë një dënim i kushtëzuar, ndërsa në seancën e kolegjit mbrojtja thekson se përkundër këtyre rrethanave dhe që ne nuk pajtohemi me asnjë lloj dënimi po jap një propozim për Gjykatën e Apelit që të shqiptohet një dënim i kushtëzuar apo një dënim me 6 muaj burgim dhe të shndërrohet ne dënim me gjobë, sa për të marrë epilog ky rast edhe pse nuk pajtohem me asnjë lloj dënimi ndaj të pandehurit.

Ndërsa, në përgjigje ne ankesë, mbrojtja thekson se pretendimet ankimore të prokurorisë janë të paqëndrueshme, lidhur me cilësinë e të pandehurit se ai ka kryer veprën penale si person zyrtar nga funksioni i ministrit, ku thekson se, vet organizimi i tillë me qytetarë e bën të pamundur kryerjen e veprës penale nga i pandehuri në një cilësi nga funksioni i ministrit, por njëkohësisht se atë ditë nuk ka pasur asnjë plan që ai të marrë pjesë si ministër dhe nuk ka shkuar me lejen e kryeministrit në një tubim të tillë me qytetarët, por njëkohësisht se ka qene ditë e diel dhe ai aty nuk ka përfaqësuar cilësinë e tij zyrtare të ministrit, por vetëm si qytetar ka folur, andaj ka theksuar se pretendimet ankimore të mbrojtjes janë të qëndrueshme e pretendimet ankimore të prokurorisë nuk gjejnë mbështetje në prova.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit lidhur me pretendimin e prokurorisë për sa i përket vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike të cilat prokuroria pretendon se kanë shkaktuar shkeljen e ligjit penal e që ndërlikohen me rikualifikimin e veprës penale, këto pretendime janë të pabazuara. Në radhë të parë është fakt se në kohën kur i pandehuri ngarkohet se ka kryer veprën penale, ai ishte në funksion të Ministrit të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Megjithatë, rezulton se ai kishte marr pjesë në një tubim që ishte organizuar me qytetarë, që nuk ishte organizuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës apo nga Ministria që e drejtonte i pandehuri. Po ashtu, në këtë tubim rezulton se ishte organizimi lidhur me çështjen e ndërhyrjes së NATOS, në Kosovë që konsiston në ndërhyrjen e datës 24.03.1999, në të cilin tubim rezulton se ishin shfaqur kundërshtime lidhur me këtë ndërhyrje – ndërsa Qeveria e Republikës së Kosovës nuk ka shpërfaqur asnjëherë kundërshtim, por gjithnjë vlerësim ndaj NATO për ndërhyrjen dhe ndaljen e luftës në Kosove. Po ashtu, rezulton se ditën kritike ai në të vërtetë nuk ishte në cilësinë e përfaqësimit si Ministër në këtë tubim, ngase nuk kishte as leje, as agjendë dhe as ndonjë njoftim në nivel të qeverise për të marrë pjesë në këtë tubim. Nga të gjitha këto arsye që Kolegji i ka gjetur se ekzistojnë në këtë çështje penale, pretendimi i prokurorisë se i pandehuri ka marrë pjesë si person zyrtar – Ministër dhe ka kryer veprën penale nga neni 147 paragrafi 2, është i pabazuar. Kjo për shkak se një Ministër nuk mund të marr pjesë në një organizim ku në vetvete ka mospërputhje me qëndrimet e atij organizimi, ndërsa vetëm fakti se ai ka pasur funksionin e Ministrit kjo nuk mund të konsiderohet se i njëjti ka vepruar në cilësinë e personit zyrtar si Ministër kur edhe ka bërë deklarinimin. Përtej këtyre rrethanave dispozita nga neni 147 paragrafi 2 përcakton këto elemente të figurës së veprës penale, Personin zyrtar, veprimin nxitës, keqpërdorimin e pozitës së tillë zyrtare. Në rastin konkret rezulton se ai nuk kishte përfaqësuar Ministrin në këtë tubim, ngase

nuk i drejtohet masës nga cilësia e tillë, po ashtu nuk rezulton se ai kishte ndonjë autorizim nga qeveria për pjesëmarrje në këtë tubim të cilin e ka keqpërdorur, çka rezulton se nuk përmbushet kushti themelor për këtë kualifikim që është keqpërdorimi i pozitës apo i autorizimit, që pretendon prokuroria se gjykata e shkallës së parë ka bere vërtetim të gabuar kur ka ri cilësuar veprën penale. Andaj për këto arsye, kolegji i gjykatës së Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejte dhe në mënyrë të plotë ka bërë vërtetimin e gjendjes faktike dhe drejtë ka vepruar kur ka bërë rikualifikimin e veprës penale dhe kur e ka shpallur fajtor të pandehurin për veprën penale nga neni 147 paragrafi 1 i KPRK-ës.

Kolegji gjen se, gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, pasi që rezulton se në veprimet e të akuzuarit janë konsumuar elementet e veprës penale nga neni 147 paragrafi 1 i KPRK-ës, rrjedhimisht drejt është aplikuar edhe ligji penal në raport me të akuzuarin kur e ka shpallur fajtor për këtë vepër penale, pasi që faktet dhe rrethanat nën të cilat është kryer vepra penale konsumojnë elementet e figurës bazë të veprës penale, nxitja e urrejtjes përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar apo etnik nga neni 147 paragrafi 1 i KPRK-ës.

Lidhur me pretendimet e prokurorisë për sanksionin pena, Kolegji i ka vlerësuar por si të tilla i gjen të pabazuara në raport me rrethanat që gjykata ka vlerësuar si ato rënduese ashtu edhe ato lehtësuese, dhe si të tilla kanë ndikuar në llojin dhe lartësinë e dënimit, kur gjykata e shkallës së parë i ka shqiptuar dënimin si në aktgjykimin e ankimuar.

Pretendimi i prokurorisë nuk konsiston në ekzistimin e ndonjë rrethane që gjykata e shkallës së parë nuk e ka marrë për bazë, pretendimi shtrihet në peshën që iu ka dhënë gjykata e shkallës së parë këtyre rrethanave që i ka vlerësuar duke bërë krahasime të rrethanave rënduese me ato lehtësuese. Pretendimi i prokurorisë se gjykata nuk është dashur ta vlerësoj rrethanën lehtësuese se i pandehuri nuk ka qenë i dënuar më parë duke marrë si shkas se vepra penale është me rrezikshmëri të larte, për Kolegjin e kësaj gjykate është i pabazuar. Rrethana e të kaluarës përcaktohet në nenin 74 paragrafi 2 nën paragrafi 2.13 të KPRK-së, ndonjë dënim të mëparshëm të personit të dënuar, gjë që në rastin konkret nuk rezulton se i pandehuri ka të kaluar kriminale që është dënuar për ndonjë vepër penale më parë, rrjedhimisht mungesa e të dhënave të tilla për dënime të mëparshme duhet vlerësuar si rrethanë lehtësuese, ndërsa përcaktimi i rrezikshmërisë është kategorizimi i vet veprës penale që përcakton edhe ndëshkueshmërinë, por duhet të kihet

parasysh se për këtë vepër penale kriteri minimal i dënimit është 30 ditë, ndërsa gjykata i ka shqiptuar dënim me 1 vit burgim.

Po ashtu qëndrimi korrekt në gjykatë, Kolegji vlerëson se nuk është vlerësuar në kuptimin figurativ qëndrimi i të pandehurit në seancë, por kjo ndërlidhet me tërësinë e procesit, si përgjigje ndaj ftesave të gjykatës, pjesëmarrja në seancë, sjellja korrekte në raport me palët dhe gjykatën, keqardhja që ka theksuar i pandehuri nëse dikush është ndier i fyer, të gjitha këto ndërlidhen me karakterin e të pandehurit dhe sjelljen e kryesit pas kryerjes së veprës penale, që përcaktohen si rrethana në nenin 74 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3, 3.11 dhe 3.12. andaj pretendimet e prokurorisë se gjykata nuk i ka peshuar drejtë rrethanat për matjen e dënimit dhe mbi këto pretendime propozimi për shqiptimin e një dënimi më të ashpër nën dritën e këtyre arsyeve të theksuara si më lartë, ky Kolegji gjen të pabazuara këto pretendime për shqiptimin e një dënimi më të ashpër, kur kihet parasysh edhe fakti se prokuroria nuk ka propozuar asnjë rrethanë që nuk është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë.

Lidhur me pretendimet e mbrojtësit të të pandehurit, për sa i përket kompetencës së Gjykatës, Fillimisht kolegji vëren se mbrojtja parashtrohet në kundërshtim kompetencën territoriale të Gjykatës Themelore dhe njëkohësisht të Gjykatës së Apelit në raport me Divizionin e Gjykatës së Apelit në Mitrovicë, që thekson se ky divizion ka kompetencë për ta trajtuar këtë çështje penale dhe jo Gjykata e Apelit.

Kolegji i kësaj Gjykatë lidhur me kompetencën territoriale, rikujton se gjykata në kompetencë territoriale ka mundësi të shpallet kompetente derisa aktakuza të marrë formën e prerë, gjë që aktakuza ka marrë shumë me parë formën e prerë, dhe pasi që akuza merr formën e prerë nuk ka mundësi që gjykata të shpallet jo kompetente në aspektin territorial, kjo sipas nenit 37 paragrafi 2 të KPP-ës.

Po ashtu lidhur me pretendimin e mbrojtjes se divizioni i Gjykatës së Apelit në Mitrovicë ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë çështje dhe jo gjykata e Apelit, kolegji rikujton se, mbështetur në nenin 43 paragrafi 2 ka përcaktuar se në çështjet penale ku prokuroria Speciale ka ne kompetencë lëndët e saja, për shqyrtimin e këtyre ankesave në lëndët e tilla është kompetente Departamenti Special pranë Gjykatës së Apelit, çka rezulton se pretendimi i mbrojtjes është i pabazuar mbështetur në dispozitat ligjore ne fuqi.

Lidhur me çështjen e përbërjes së kolegjit ku mbrojtja ka parashtruar në seancën e kolegjit pranë Gjykatës se Apelit se përbërja e kolegjit nuk mund të jetë e tillë siç ishte në rastin konkret por duhet të jenë dy gjyqtarë serb dhe një shqiptar, kolegji lidhur me këtë pretendim ka parasysh se në këtë çështje penale për pretendimet e njëjta të mbrojtjes ekziston një vendim i Kryetarit të Gjykatës se Apelit që ishte refuzuar një pretendim i tillë e që çështja ishte shqyrtuar edhe në Gjykatën Supreme dhe pretendimet e tilla të mbrojtjes kanë rezultuar si të pabazuara, çka nënkupton se pretendimi me bazë të njëjtit për përjashtim të gjyqtarëve nga kolegji, sipas nenit 40 paragrafi 6 i KPP-ës, shkaqet e njëjta për përjashtim nuk mund të paraqiten nga pala.

Andaj për këto arsye kolegji i gjen pretendimet e mbrojtjes të pabazuara që ndërlidhen me kompetencën territoriale, lëndore dhe funksionale.

Kolegji ka vlerësuar pretendimet ankimore të mbrojtjes së të pandehurit për shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale në raport me nenin 384 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 lidhur me nenin 370 paragrafi 7 të cilat mbrojtja i ka ndërlidhur me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike.

Për sa i përket pretendimeve për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, Kolegji gjen se aktgjykimi nuk është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale që do të kushtëzohin anulimin e tij, me konkretisht aktgjykimi në dispozitiv përmban të gjitha rrethanat e fakteve që si të tilla shpërfaqin konsumimin e elementeve të figurës së veprës penale për të cilën i pandehuri është shpallur fajtor, dispozitivi është i qartë dhe konkret tregon, kohën e kryerjes së veprës penale, vendin se ku është kryer vepra penale, veprimin konkret të të pandehurit, dhe rrezikun që mund të prishin rendin publik, në këtë kuptim dispozitivi i aktgjykitimit është konkret i qartë dhe specifik në raport me veprimet e të pandehurit, nuk ka paqartësi dhe kundërthënie në tërësinë e rrethanave faktike të kësaj çështje penale.

Po ashtu aktgjykimi në arsyet e tij paraqet në mënyrë të qarte faktet relevante se mbi cilat prova janë vërtetuar ato fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron gjykata të vërtetuara, përbën arsyet konkrete në raport me veprimet e të pandehurit, vlerësimin ligjor të veprimeve të tilla, vlerësimin e provave konkrete se cilat fakte kanë vërtetuar dhe cilave prova ua ka falur besimin gjykata e shkallës së parë, andaj bazuar në arsyet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë ato si të tilla janë të qëndrueshme për këtë kolegji dhe njëkohësisht janë arsye të logjikshme konkrete në raport me faktet relevante që shërbejnë për marrjen e aktgjykitimit, për këto arsye Kolegji vlerëson se

pretendimet e mbrojtjes se aktgjykimi është i përfshirë me shkelje esenciale te dispozitave të procedurës penale i gjen si të pabazuara.

Lidhur me pretendimet e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, Kolegji i kësaj gjykate i gjen të pabazuara pretendimet e tilla, përkatësisht pretendimet e mbrojtjes se nuk kemi të bëjmë me vepër penale, por me delikt verbal përkatësisht se kemi të bëjmë me të drejtën e lirisë së shprehjes të përcaktuar sipas KEDNJ-ës, këto pretendime janë të pabazuara.

Kolegji ka parasysh se, nuk ka mëdyshje se e drejta e lirisë se shprehjes është një e drejtë themelore e garantuar sipas Konventës për të drejtat dhe liritë e njeriut, e cila gjen zbatim të drejtpërdrejt në të drejtën e vendit, po ashtu kjo e drejtë si e tille është e mishëruar edhe në nenin 40 të Kushtetutës së Vendit, çka nënkupton se nuk ka mëdyshje që në Kosovë garantohet e drejta e lirisë së shprehjes sipas akteve ndërkombëtare që gjejnë zbatim dhe sipas Kushtetues. Megjithatë si Dispozita nga neni 10 i Konventës ashtu edhe paragrafi 2 “ *Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor. Po ashtu paragrafi 2 i nenit 40 të Kushtetutës së vendit ka përcaktuar kufizimet e kësaj të drejte, “ *Liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare*”.*

Kolegji ka parasysh se dispozita e kodit penal ka përcaktuar saktësisht kufizimet që lejojnë dispozita e paragrafi 2 të nenit 10 të KEDNJ-ës dhe të nenit 40 të Kushtetutës së vendit, ngase kjo vepër penale ka ne vetvete objekt mbrojtës, rendin kushtetues dhe të sigurisë, gjë që mungesa e rendit kushtetues – juridik, shkakton pasigurinë dhe njëkohësisht shkakton armiqësi.

Për të vlerësuar pretendimet e mbrojtjes që ndërlihen me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike, Kolegji vlerëson se duhet të kihet parasysh disa rrethana, konkretisht konteksti i ngjarjes, qëllimi që ekziston e që materializohet përmes veprimit konkret si dhe pasojat që mund të krijohen, mbi

bazën e këtyre rrethanave të vlerësohet se a kemi të bëjmë me liri të shprehjes siç mbrojtja pretendon apo kemi të bëjmë me veprim inkriminues.

Qëllimi në vetvete konsiston si veprim i përhapjes së shprehjes për nxitjen kundër një grupi te caktuar apo individ, që mund të përbëjë urrejtje apo mos durim kombëtar.

Në rastin konkret i pandehuri I.T., me datë 24.03.2019 me rastin kur i drejtohet masës së qytetareve të komunitetit serb, kishte deklaruar, “ *Arsyeja për agresionin ne shtetin tone ka gene e ashtuquajtura katastrofë humanitare, Reçaku u shpik ne Kosove e Metohi dhe ishin ata terroristet shqiptar qe shpiken te gjitha këto, kryen krimet me te mëdha ne Kosove dhe Metohi për te cilat askush deri me sot nuk ka marr përgjegjësi. Kane kryer krime para agresionit te NATO-s, kane vrarë shtëpiak te mire serb dhe polic ne vendin e tyre te punës, vazhduan festen e përgjakshme gjate agresionit dhe pas ardhjes te se ashtuquajturës mision paqësor ne Kosovës e Metohi*”.

Deklarimet e tilla të të pandehurit, në kontekst të rrethanave shpërfaqin plotësisht qëllim të urrejtjes, kjo për faktin se, tubimi ishte i organizuar nga qytetarët e komunitetit serb, kur ai merr fjalën, përdor shprehjet përbuzëse dhe fyese me epitete për një grup tjetër kombëtar në rastin konkret për shqiptarët, ngase, cilëson rrethana të ngjarjes gjatë vitit 1999 – Reçakun, si shpikje që është një shprehje fyese dhe përbuzëse për një komunitet, por posaçërisht për viktimat që kane pësuar në atë ngjarje, po ashtu përdor epitetet për një komunitet të tërë “terroristët shqiptar” që kjo fjali në vetvete vënë theksin e mos durimit kombëtar si qëllim pasi që në tërësi përfshin komunitetin me epitetin “terroristët shqiptar”, po ashtu deklarimi për gjërat që nuk ka asnjë konfirmim se ata kanë vrarë shtëpiak të mire serb dhe polic të mirë, që vihet theksi në raport me një komunitet të tërë dhe jo me ndonjë individ konkret, e që po ashtu shpërfaq mos durimin kombëtar. Këto deklarime në raport me kontekstin e ngjarjes që kanë ndodhur ku ishin të organizuar qytetarë të komunitetit serb në tubim ndërsa i pandehuri në fjalimin e tij marrë për bazë edhe faktin se ai ishte pjesëtar i një subjekti politik që për kontekstin ka rëndësi, e i cili në deklaram vë theksin tërësisht ndaj një komuniteti tjetër – shqiptar, vërtetojnë plotësisht ekzistimin e qëllimit për nxitjen e urrejtjes që i pandehuri kishte me rastin e veprimit të tij.

Kolegji i gjykatës së Apelit lidhur me pretendimin e mbrojtjes se nuk ka pasur asnjë lloj pasoje, ka parasysh se për rrethanat e tilla që ndërlidhen me pasojat cila është kërkesa ligjore, sipas nenit 147 paragrafi 1, kjo dispozitë përcakton se “nxitja apo përhapja publikisht e urrejtjes në mënyrën e cila mund të prishe rendin publik....”

Dispozita ligjore ne rastin konkret nuk kërkon shkaktimin e pasojës, por përcakton mundësinë e shkaktimit të prishjes së rendit publik. Në këtë kuptim Kolegji vlerëson se mundësia në rrethana të rastit konkret ekziston për prishje të rendit publik, pasi që nga vet qëllimi dhe nxitja e përçarja që kishte në fokus grup të caktuar shoqëror – shqiptarët, nga deklarimi i të pandehurit, rezulton edhe mundësia reale që të prishet rendi publik. Në këtë kontekst dispozita nuk kërkon shkaktim të veprimeve reale si pasojë në kuptim të destabilizimit të rendit publik, por kjo dispozite si pasojë kërkon mundësinë e prishjes së rendit që konsiston se gjuha e tillë ka aftësi reale që të qojë në prishjen e rendit publik. Pretendimi i mbrojtjes, se nuk ka ndodhur asnjë protestë, asnjë bllokim rruge për ta paraqitur si mungesë pasojën e veprimeve të të pandehurit, për Kolegjin janë te pabazuara pasi që një formë të tillë të pasojës e kërkon paragrafi 2 i nenit 147 dhe jo paragrafi 1 i nenit 147 të KPRK-së, për të cilën është shpallur fajtor i pandehuri, andaj rrjedhimisht Kolegji vlerëson se ne veprimet e të pandehurit janë përmbushur të gjitha elementet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor.

Kolegji i gjykatës se Apelit i ka vlerësuar edhe rrethanat e rasteve që mbrojta i ka prezantuar kur konsistojnë në krahasim të shprehjes së lirë, që thekson, se “mund të deklaroj se Skënderbeu është serb dhe M.K. është shqiptar, apo se mund të mohojë hedhjen e bombës atomike ne Hiroshimë dhe Nagasaki dhe ajo ishte një propagandë e shtetit të Japonisë, apo shembuj të tjerë”, megjithatë Kolegji ka parasysh se rastet e tilla nuk kanë as kontekst dhe as qëllim andaj me të drejtë rezultojnë si shprehje që mund të gjykohen sipas normave morale, por në veprimet e të pandehurit për arsyet e dhëna dhe konkretisht, vënia e fokusit të një grupi të shoqërisë, epitetet e vëna ndaj grupit theksime të rrethanave në raport me ngjarjet historike, dhe përfshirja e një grupi të tërë të shoqërisë si vrasës konsiston vetëm në një qëllim që është nxitja e urrejtjes dhe përçarjes, e kur kihet parasysh konteksti se ku ishte bërë dhe në çfarë rrethanash kjo përhapje e urrejtjes, të gjitha këto përtej çdo dyshimi vërtetojnë se kemi të bëjmë me veprim inkriminues që është ne kategorinë e qëllimit legjitim të ruajtjes së rendit publik në një shoqëri demokratike, dhe rrjedhimisht rezulton brenda kategorisë së kufizimit të lirisë së shprehjes që e përcakton edhe paragrafi 2 i nenit 10 të Konventës, ngase vetëm në këtë formë mund të arrihet deri te qëllimi legjitim për ta ruajtur rendin dhe harmoninë ndërmjet komuniteteve që janë pjese përbërëse në shoqërinë demokratike të vendit.

Kolegji i Gjykatës se Apelit, pretendimet e mbrojtjes për shkeljen e ligjit penal i vlerëson si të pabazuara. Më konkretisht, Kolegji vlerëson se në veprimet e të akuzuarit janë konsumuar elementet e veprës penale nga neni 147 paragrafi 1 për të cilën vepër penale është shpallur fajtor

i pandehuri. Vendi i kryerjes se veprës penale, koha e kryerjes konteksti dhe rrethanat ku i pandehuri kishte bërë përhapjen e deklaramit me qellim të nxitjes së urrejtjes i cili deklarim orientohet konkretisht në raport me një grup shoqëror me baze kombëtare dhe etnike, rrethana këto që realisht nga gjuha e përdorur kjo gjuhë është e aftë që mund të shkaktoj prishje të rendit publik. Të gjitha këto shpërfaqin elementet e figurës së veprës penale për të cilën i pandehuri është shpallur fajtor, andaj Kolegji vlerëson se drejtë është zbatuar ligji penal, në rastin konkret ngase këto rrethana të fakteve saktësisht konsumojnë elementet e kësaj vepre penale e që rezulton se kjo gjendje faktike i nënshtrohet në tërësi kësaj norme të kodit penal.

Kolegji nuk i gjen të bazuara pretendimet e mbrojtjes lidhur me pretendimin për shkelje të ligjit penal kur theksohet në ankesë, se në këtë çështje penale nuk është cenuar rendi publik siç ka konstatuar gjykata e shkallës së parë, dhe kur mbrojtja pretendon se nuk janë shkaktuar as trazira as protesta dhe as bllokim rrugësh, e që rrjedhimisht siç theksohet nuk kemi të bëjmë me vepër penale që për pasojë të kësaj theksohet se është shkelur ligji penal në dëm të të pandehurit.

Kolegji rithekson se dispozita nga paragrafi 1 i nenit 147 inkriminon veprën penale bazë të nxitjes së urrejtjes përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor fetar apo etnik, kjo formë themelore e inkriminimit përcakton pasojë mundësin e shkakimit të prishjes së rendit publik, çka nënkupton se kjo dispozitë ligjore nuk kërkon shkakimin real në mënyrë faktike prishjen e rendit publik, por konsiston vetëm në mundësinë që gjuha e tillë që përdoret është nxitëse apo përhapje publikisht e urrejtjes, dhe ka aftësinë që për shkak të kësaj gjuhe mund të prishet rendi publik. Andaj, mbi këto arsye Kolegji vlerëson se pretendimi që mbrojtja thekson se nuk është shkaktuar asnjë trazirë, protestë bllokim rruge apo ndonjë formë tjetër, kjo konsiston në shkakimin real të pasojës që një pasojë e tillë përcaktohet në paragrafin 2 të formës së kualifikuar që është në nenin 147 të KPRK-ës, mbi këto rrethana pretendimet e mbrojtjes kolegji i gjen të pabazuara, rrjedhimisht vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar ligjin penal kur të pandehurin e ka shpallur fajtor për këtë vepër penale.

Lidhur me pretendimet e mbrojtjes për sanksionin penal, që në ankesë mbrojtja thekson se përderisa nuk kemi fare vepër penale edhe dënimi është tërësisht kundërligjor, megjithatë mbrojtja thekson se një dënim i tillë nuk ekziston në praktikën gjyqësore të vendit, në ndonjë shtet evropian apo në Amerikë, ngase është dënim shumë i ashpër, ndërsa thekson se edhe në rastin e S. që veprimet ishin shume më të renda, ndaj tij është shqiptuar dënim i kushtëzuar. Ndërsa, në seancë thekson se edhe pse nuk pajtohem me asnjë dënim në propozojmë që ndaj të

pandehurit nëse gjykata gjen se veprimet e tij përbëjnë vepër penale atëherë të shqiptohet një dënim me kusht apo me burgim 6 muaj burgim i cili dënim të zëvendësohet në dënim me gjobë.

Kolegji vlerëson se pretendimet ankimore të mbrojtjes nuk janë të bazuara për sa i përket sanksionit penal. Fillimisht Kolegji vëren se mbrojtja nuk thekson rrethana që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, por thjesht referon çështje të praktikës, në këtë këndvështrim Kolegji rikujton se çdo çështje penale pranë gjykatës kur konstatohet fajësia e të pandehurit duhet vlerësuar rrethanat në raport me rastin konkret dhe dënimi nuk mund të jetë substrat i praktikës gjyqësore pasi që rrethanat janë specifike në secilin rast konkret, në këtë kuptim kolegji vëren se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar rrethanat rënduese dhe lehtësuese në këtë çështje penale, ku si rrethana lehtësuese janë vlerësuar se i pandehuri nuk ka dënime të mëparshme, pendimin e tij dhe sjelljen e tij korrekte gjatë gjykimit, ndërsa si rrethana rënduese ka vlerësuar peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit, duke marrë për bazë motivin dhe planifikimin që është bërë më parë, dhe rrethanat nën të cilat është kryer vepra penale, mbi këto rrethana ka përcaktuar se dënimi i tillë është në proporcion me peshën e veprës penale dhe se me anë të këtij dënimi do të arrihet qëllimi i dënimit.

Kolegji vlerëson se pretendimet ankimore në asnjë rrethanë nuk argumentojnë mungesën e ndonjë rrethane që gjykata e ka vlerësuar, por thjesht theksohet proporcionalitetit nga ana e mbrojtjes. Për këtë Gjykatë, proporcionalitetit duhet të jetë i mbështetur në faktorët që ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe të lartësisë së dënimit, gjë që në rastin konkret këta faktorë janë theksuar nga gjykata e shkallës së parë, po ashtu dënimi është i shqiptuar brenda kufijve ligjore që përcaktohet për këtë vepër penale, në këtë këndvështrim duke i pranuar rrethanat që gjykata e shkallës së parë i ka pas për bazë kur ka vlerësuar për llojin dhe lartësinë e dënimit, po ashtu vlerëson se natyra e gjuhës së përdorur si mënyrë për nxitjen ose përhapjen e urrejtjes nuk argumenton në asnjë rrethanë një dënim që do të konsiderohej se do të arrihej qëllimi i dënimit vetëm me kërcënimin ndaj të pandehurit siç është dënimi i kushtëzuar që mbrojtja ka propozuar, kjo për faktin se në rastin konkret përdoren edhe viktimat për qëllim që i pandehuri ka pasur kur ka kryer veprën penale, ndërsa lidhur me propozimin për dënim me burgim dhe shndërrimin e tij në dënim me gjobë, ky Kolegj vlerëson po ashtu se këto pretendime janë të pabazuara pasi që në tërësinë e rrethanave rënduese dhe lehtësuese të rastit konkret e duke vlerësuar se kjo Gjykatë nuk ka gjetur të bazuar pretendimet e mbrojtjes si të bazuar për një dënim më të ulët me burgim rrjedhimisht edhe propozimi për caktim të një dënimi me burgim deri në 6 muaj dhe shndërrimin e tij në gjobë i gjen të pabazuara.

Andaj për arsyet e theksuara si më lartë kjo Gjykatë bazuar në nenin 401 të KPP-ës, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

APS.nr.2/2023 me datë 20.02.2023

B.profesionale
Alba Makolli

Anëtarët e kolegjit
Burim Ademi

Afërdita Bytyqi

Kryetar i kolegjit,
Bashkim Hyseni
